

# HERITAGE LAB RINGJALLJA E TRASHËGIMISË SË LETNICËS

Raport nga punëtoria  
zhvillimore

Gusht 2020

osbe

Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Misioni në Kosovë

CH  
WB  
Cultural  
Heritage without Borders  
KOSOVO



Ky raport është rezultat i bashkëpunimit midis Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Trashëgimisë Kulturore pa Kufij. Pikëpamjet dhe mendimet e pasqyruara në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos ato të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

*Figura 1 – Foto e kopertinës, Ilustrim, pamje ajrore e fshatit Letnicë në pjesën jugore të Kosovës.*

© Misioni i OSBE-së në Kosovë, Prishtinë, 2020



*Figura 2 – Kampi i Restaurimit në fshatin Letnicë:  
vizitë në vend nga pjesëmarrësit.  
Foto: OSCE/CHWB Dardan Rushiti*

# HERITAGE LAB RINGJALLJA E TRASHËGIMISË SË LETNICËS

Raport nga punëtorja  
zhvillimore

# FJALË HYRËSE



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është angazhuar për shumë vite në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si mjet për promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor. Më saktë, ky detyrim lindi gjatë ekzistencës së KSBE-së, Konferencës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Evropian, nga e cila u themelua OSBE-ja. Në Simpoziumin e Krakovit për Trashëgiminë Kulturore të Shteteve pjesëmarrëse të KSVE-së, mbajtura më 1991, Shtetet pjesëmarrëse "riafirmuan bindjen e tyre se respektimi i diversitetit kulturor promovon mirëkuptimin dhe tolerancën midis individëve dhe grupeve." Për më tepër, u ra dakord që "partneritetet midis grupeve të ndryshme në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar... janë të vlefshme për të siguruar ruajtje efikase dhe përfaqësuese të trashëgimisë kulturore", dhe se kjo është "...adequate për tolerancën dhe respektimin e kulturave të ndryshme..."

*Figura 3 – Ambasadori Jan Braathu, shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, në ceremoninë e mbylljes së Punëtorisë së "Heritage Lab", 5 korrik 2019.  
Foto: OSCE/CHWB Dardan Rushiti*

Dokumenti i Krakovit ishte udhëzues dhe frymëzim për punën e Misionit të OSBE-së në Kosovë në fushën e trashëgimisë kulturore për më shumë se njëzet vjet. Në punën e Misionit tonë, ne kemi mëtuar të kontribuojmë në partneritetet lokale me një qasje gjithëpërfshirëse për të gjitha komunitetet. Në të vërtetë, kjo është mënyra më e mirë për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë e pasur dhe të larmishme kulturore të Kosovës duke nxitur mirëkuptim dhe dialog midis komuniteteve. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore ka një sërë aspektesh, përfshirë ngritjen e vetëdijes publike, kontributin në legjislacion, përmes monitorimit të mënyrës së zbatimit të legjislacionit, deri tek mbështetja e ngritjes së kapaciteteve dhe transferimi i praktikave më të mira tek kolegët dhe institucionet vendore.

Një numër i madh i përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme, organizatave joqeveritare (OJQ), si dhe praktikues dhe studentë, fituan njohuri, aftësi dhe shkathtësi të reja se si të ruajnë më mirë trashëgiminë e pasur kulturore në Kosovë dhe si ta përdorin atë si mjet për bashkëpunim ndërmjet komuniteteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore.

Projekti "Rizbulimi i Trashëgimisë së Letnicës" më 2018 dhe 2019 adresoi disa aspekte të rëndësishme: nga njëra anë, mbledhi studentë - si kujdestarë të ardhshëm të trashëgimisë kulturore të Kosovës - me standarde dhe teknika të njohura ndërkombëtarisht për menaxhimin e trashëgimisë dhe valorizimin socio-ekonomik të saj. Nga ana tjetër, ajo përfaqësoi një iniciativë të Misionit të OSBE-së në Kosovë për të përmirësuar kapacitetin e komuniteteve joshumicë.

/04

Misioni përzgjedhi fshatin etnikisht të përzier të Letnicës (komuna e Vitisë) për të përgatitur një plan të zhvillimit të trashëgimisë kulturore që do të ofrojë një mundësi për të filluar zhvillimin e qëndrueshëm lokal duke mobilizuar burimet e veta të fshatit, duke theksuar trashëgiminë e tij unike kulturore.

Shpresojmë që rezultati i këtij ushtrimi, i theksuar në këtë botim, do të kontribuojë në një jetë dhe dinjitet më të avancuar dhe respektim të ndërsjellë të komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

Dua të falënderoj të gjithë pjesëmarrësit, mes së cilëve, studentët e Universitetit të Prishtinës, Trashëgiminë Kulturore pa Kufij, Kryetarin e Komunës dhe Komunën e Vitisë si dhe banorët e fshatit Letnicë.

Jan Braathu

Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Prishtinë, korrik 2020.

# PARATHËNIE



Figura 4 – Sali Shoshi drejtor i “Trashëgimia Kulturore pa Kufij”, në ceremoninë e mbylljes së Punëtorisë së “Heritage Lab”, 5 korrik 2019.  
Foto: OSCE/CHWB Dardan Rushiti

Trashëgimia kulturore dhe natyrore në Kosovë është resurs social e ekonomik i pashfrytëzuar. Të paktë janë njerëzit jashtë rrethinës së afërt që të kenë dëgjuar ndonjëherë për malet e gjelbra me përrenjtë e rrëmbyer, fshatrat e paprekura dhe trashëgiminë kulturore të begatë të Kosovës. I këtillë është rasti i Letnicës, një fshati të vogël që ndodhet në Malet e Karadakut në afërsi të kufirit me Republikën e Maqedonisë Veriore. Mu në këtë fshat, një vajzë e vogël me emrin Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, të cilën më vonë bota do ta njihje si Nënë Tereza e Kalkutës, pranoi thirrjen e përjetshme fetare. Gjersa në nivel lokal Letnica ka fituar famë dhe vizitohet po për këtë arsye, fatkeqësisht fshati po përballet me sfida të shumta, përfshirë këtu popullatën që po plaket, shpopullimin dhe degradimin fizik të vendbanimit. Megjithatë, ende ka shpresë.

Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB), me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ka filluar përpjekjen më të fundit për zhvillimin e komunitetit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare: *Ringjallja e trashëgimisë së Letnicës – në gjurmët e Nënë Terezës së Kalkutës*. OSBE dhe CHWB i kanë adresuar këto çështje së fundmi në një varg kampesh verore për të rinjtë që u organizuan në 2018 dhe 2019. Kampet synonin bërjen e intervenimeve fizike dhe planifikimin për zhvillimit strategjik në këtë lokalitet, ku një ndër rezultatet e arritura është ky raport. Ai përvijon një plan zhvillimor fillestar për të siguruar mbijetesën e komunitetit të mbetur bashkë me trashëgiminë e tyre kulturore.

Raporti është vetëm se një hap i parë drejt zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të fshatit, megjithatë, e shtron rrugën për të ardhmen e Letnicës. Hulumtimet e realizuara dhe idetë e dhëna janë pikënisje për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij fshati që mund të kthehet në një shembull për gjitha vendbanimet e tjera rurale në Kosovë.

**Sali Shoshi**

Drejtor Ekzekutiv i

Fondacionit Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij.

Prishtinë, korrik 2020.

# PARTNERËT

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)** ka një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë, ku përfshihen aspektet politiko-ushtarake, ekonomike, mjedisore dhe humane. Kështu, ajo adreson një gamë të gjerë të shqetësimeve të lidhura me sigurinë, përfshirë kontrollin e armëve, promovon masa për ngritjen e besimit dhe sigurisë, të drejtat e njeriut, përfshirë këtu dhe ato të komuniteteve joshumicë, dhe fuqizon demokracinë, strategjitë e punës policore, luftën kundër terrorizmit, si edhe ndaj sfidave ekonomike e mjedisore.

Si një nga operacionet më të mëdha në terren të OSBE-së, Misioni i OSBE-së në Kosovë realizon një sërë aktivitesh në fushën e të drejtave të njeriut, demokratizimit dhe sigurisë e rendit publik. Misioni angazhohet posaçërisht në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, monitorimin e gjyqësorit, integrimin gjinor, lirinë dhe zhvillimin e medieve, promovimin e mekanizmave kundër diskriminimit, përmirësimi e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike dhe publike, luftimin e terrorizmit dhe rreziqeve kibernetike, ofrimin e trajnimeve të avancuara për policinë dhe mbështetjen e strategjive kryesore policore dhe të sigurisë, si dhe mbështetjen për zbatimin e marrëveshjeve që rrjedhin nga dialogu i lehtësuar nga Bashkimi Evropian mes Prishtinës dhe Beogradit. Gjithashtu, Misioni monitoron punën e institucioneve të ndryshme dhe ndihmon në forcimin e legjislacionit dhe politikave në fushën e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve, mosdiskriminimit, lirisë së shprehjes, barazisë gjinore dhe luftimin të korrupsionit e krimit të organizuar.

[www.osce.org/mission-in-kosovo](http://www.osce.org/mission-in-kosovo)

*Figura 5 – Punë praktike gjatë punëtorisë rreth konservimit.  
Foto: OSCE/CHWB Dardan Rushiti*



**Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB)** u themelua si organizatë joqeveritare suedeze e pavarur e dedikuar për shpëtimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale të prekur nga konflikti, neglizhenca, apo fatkeqësitë natyrore ose të shkaktuara nga njeriu. Ne e shohim punën tonë si një kontribut vital në ndërtimin e demokracisë dhe mbështetjen e të drejtave të njeriut. CHwB është neutrale sa u përket palëve në konflikt, por jo në të gëzuarit e të drejtave në trashëgimi kulturore nga të gjithë njerëzit - sot dhe në të ardhmen. Trashëgimia Kulturore pa Kufij punon me trashëgiminë kulturore si forcë aktive në pajtim, ndërtim të paqes dhe zhvillim ekonomik e social duke krijuar kapacitetet, ngritur ndërgjegjësimin dhe mundësitë për zhvillim. CHwB angazhohet për barazi, mosdiskriminimin, pjesëmarrje, llogaridhënie dhe transparencë.

**VIZIONI YNË** është që gjithsecili ta ketë të drejtën që ta gëzojë, të ketë qasje dhe të merr pjesë në trashëgiminë kulturore.

**MISIONI YNË** është promovimi i trashëgimisë kulturore si e drejtë në vetvete dhe njëkohësisht dhe si pasuri. Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij punon me shoqërinë civile dhe institucionet në të gjitha nivelet, për ta forcuar ndërtimin e paqes, zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik e demokratik, si dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut.

Një ndër projektet e fundit dhe me rëndësi është realizuar në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë në fshatin Letnicë, ku në fokus kanë qenë njëherazi ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi social e ekonomik i komunitetit të atyshëm.

[www.chwb.org/kosovo/](http://www.chwb.org/kosovo/)

# HERITAGE LAB

*Figura 6 – Punëtorja “Heritage Lab”, 24 qershor - 5 korrik 2019, mbledhi studentë nga fusha të ndryshme akademike si arkitektura, trashëgimia kulturore, sociologjia, antropologjia dhe etnologjia. Foto: OSCE/CHWB Dardan Rushiti*

HERITAGE  
LAB

“Heritage Lab” është projekt edukativ i organizuar nga Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij që synon të krijojë mundësi të reja për të rinjtë në moshë madhore me përgatitje profesionale të ndryshme që të mësojnë rreth trashëgimisë - vlerat, rëndësinë, konservimin, përfshirë dokumentimin e interpretimin. Kjo arrihet përmes punës praktike në lokacionet gjegjëse dhe ligjëratave plotësuese. “Heritage Lab” është aktivitet që zhvillohet në lokacion në mënyrë që problemet e një lokaliteti të trashëgimisë të mund të vlerësohen drejtpërsëdrejti, dhe që zgjidhjet e mundshme për sa i përket trajtimit, interpretimit dhe menaxhimit të mund të jetësohen njëkohësisht.

Punëtoritë në kuadër të “Heritage Lab” mbledhin studentë nga fusha të ndryshme akademike, siç janë arkitektura, trashëgimia kulturore, sociologjia, antropologjia dhe etnologjia, të cilët kanë pasion trashëgiminë kulturore të Kosovës. Gjatë punëtorive, pjesëmarrësit mësojnë rreth mënyrave të ruajtjes dhe interpretimit të trashëgimisë kulturore. “Heritage Lab” u jep pjesëmarrësve mundësinë për të mësuar nga ligjërimet e ekspertëve ndërkombëtarë e vendorë në fushën e konservimit, interpretimit dhe zhvillimit socioekonomik. Përveç ligjëratave, pjesëmarrësit kryejnë punë praktike/në terren ku mësojnë metodat e konservimit të ndërtesave historike, rivitalizimin sipas nevojave moderne, si dhe interpretimin e trashëgimisë kulturore.

Në tetor të vitit 2018 dhe në verën e vitit 2019 në fshatin Letnicë janë mbajtur dy seanca të “Heritage Lab”. Seanca e parë ngërthente punë konservimi në terren të kryera në Mullirin e Frrok Dokiçit dhe interpretimin e fshatit përmes rrëfenjave dhe shenjave për vizitorë. “Heritage Lab” i vitit 2019 kishte në fokus vazhdimin e punës konservuese tek Mulliri dhe hartimin e rekomandimeve për një plan të ardhshëm të zhvillimit rural.



*Figura 7 – Punëtorja në kuadër të “Heritage Lab” për ringjalljen e trashëgimisë së Letnicës.  
Foto: OSCE/CHWB Dardan Rushiti*

# MIRËNJOHJE

Ekipi i "Heritage Lab" në kuadër të Fondacionit Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij dëshiron që në radhë të parë t'i falënderohet komunitetit të Letnicës për mikpritjen. Gjatë vjeshtës së vitit 2018 dhe verës së vitit 2019, në këtë fshat zbankuan me dhjetëra pjesëmarrës të kampit dhe profesionistë, për të punuar, identifikuar dhe fotografuar komunitetin, objektet dhe natyrën e atyshme. Komuniteti u tregua shumë i këndshëm dhe i hapur ndaj gjithë atyre të rinjve energjikë dhe shpesh merrte pjesë në intervista.

Ekipi duhet ta falënderojë gjithashtu Misionin e OSBE-së në Kosovë për mbështetjen e dhënë për "Heritage Lab". Kjo përpjekje do të kishte qenë e pamundur të realizohej po të mos ishte mbështetja e palëkundur e OSBE-së. Falë angazhimit dhe vizionit afatgjatë në çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në Kosovë, OSBE ofroi këshilla të dobishme në lidhje me nevojat më të mëdha për sa i përket trashëgimisë kulturore nëpër zona rurale dhe vendosi përfundimisht edhe për vendndodhjen e projektit. Për më tepër, një ndër kontributet vendimtare për suksesin e këtij projekti ka qenë mbështetja financiare e Misionit të OSBE-së në Kosovë për organizimin e "Heritage Lab" dhe për publikimin e këtij raporti.

U jemi mirënjohës po ashtu dhe ekspertëve të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë që erdhën në këtë fshat të largët për të ndarë njohuritë e tyre rreth konservimit, interpretimit dhe zhvillimit. Zemërgjerësia e tyre ka begatuar edukimin e të rinjve të shumtë dhe ka kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë në Kosovë.

Në fund, falënderime u shkojnë dhe komunitetit kulturor në përgjithësi në Kosovë, dhe studentëve të cilët morën pjesë. Programe të tilla si "Heritage Lab" nuk do të kishin qenë të mundura pa një përkrahje kaq të gjerë. Mbështetja përmes përhapjes së lajmit, shpërndarjes së informatave nëpër universitete, si dhe mirëkuptimi i familjeve dhe punëdhënësve që lejuan studentët të merrnin pjesë kanë qenë çelësi i suksesit të këtij programi. Vazhdimësia e përpjekjeve të sotme për konservim të trashëgimisë në të ardhmen mund të arrihet vetëm përmes angazhimit të brezave të ardhshëm.

Me nderime,

Ekipi i Heritage Lab | Fondacionit Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij, Kosova

HERITAGE  
LAB

*Figura 8 - Puna e konservimit gjatë punëtorisë u përqendrua në Mullirin e Frrok Dokiçit.  
Foto: OSCE/CHWB Dardan Rushiti*

# PËRMBAJTJA

- /03 Fjalë Hyrëse**
- /05 Parathënie**
- /07 Partnerët**
- /09 Heritage Lab**
- /11 Mirënjohje**
- /12 Përmbajtja**
- /13 Përmbledhje ekzekutive**
- /15 Kreu I - Hyrje**
  - /16 Historia e Letnicës
  - /19 Përkufizimi i zhvillimit
  - /21 Arsyeja, metodologjia, struktura
- /23 Kapitulli II - Të kuptuarit e Letnicës**
  - /23 Gjendja sociale
  - /26 Gjendja ekonomike
  - /28 Mjedisi dhe bujqësia
  - /29 Kultura, turizmi dhe festivale
  - /31 Analizë dhe SWOT
- /35 Kapitulli III - Plani i propozuar i zhvillimit**
  - /35 Social
  - /37 Ekonomia
  - /40 Mjedisi
  - /41 Kultura
- /44 Konstatime**
- /45 Shtojcë**
  - /45 Hartat - Rajonale
  - /46 Konteksti
  - /51 Hartat historike
  - /53 Indeksi i figurave
  - /55 Bibliografi
  - /59 Programi i Heritage Lab 2019
  - /61 Autor
  - /62 Kontribues

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raporti i përshkruan rezultatet e një punëtorie dyjavore mbi zhvillimin rural të mbajtur në kuadër të “Heritage Lab” në fshatin Letnicë të Kosovës. Procesi i përpilimit të planit për zhvillim rural është vetëm se në fazat fillestare, megjithatë, që tani ka sjellë disa rezultate interesante dhe të dobishme. Në këtë raport përshkruhen problemet kryesore, shkaqet e tyre, si dhe shumë aspekte pozitive të fshatit të cilat mund të zhvillohen më tej për ndryshime të qëndrueshme. Raporti përmban rekomandime të gjerësishme zhvillimore që janë kategorizuar në katër kategori të përgjithshme, për të pasqyruar katër shtyllat e zhvillimit: social, ekonomik, mjedisor dhe kulturor.

## Mirëqenia sociale

- Të punohet me komunitetin, udhëheqësit lokalë dhe institucionet për të ndërtuar një vizion të përbashkët në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm
- Të krijohet Fondacioni “Letnica thërret”, për të avokuar, bashkërenduar dhe udhëhequr me përpjekjet zhvillimore
- Të tërhiqen familjet dhe çiftet e reja në Letnicë përmes një programi informues dhe të sigurohet vazhdimësia dhe funksionimi i shkollës fillore dhe vendtubimeve tjera shoqërore
- Të përmirësohen shërbimet publike themelore sikurse shtëpia e shëndetit dhe lidhjet e transportit publik përmes vënies në dispozicion të një autobusi, gjë që do përmirësojë njëherësh dhe qasjen në kujdes shëndetësor
- Të nxitet zhvillimi i vendtubimeve sociale duke filluar nga ato të voglat (tregjet lokale) e deri te më të mëdhatë (festivale) për t'i dhënë komunitetit mundësi për ndërveprim

## Ekonomia

- Të nxitet zhvillimi i bujqësisë në shkallë të vogël përmes disa nismave, duke përfshirë shitjen e drejtpërdrejtë fermë-treg/rurale-urbane, krijimin e një kooperative dhe trajnimin e fermerëve
- Të shtohen ofertat aktuale turistike si qendër pelegrinazhi fetar
- Të zgjatet koha të cilën turistët e kalojnë në fshat, nga 2 ditë sa është tani në 5 ditë
- Të rritet numri i festivaleve fetare nga Kremta e Zojës së Madhe si e vetmja tani për tani, për të përfshirë dhe Krishtlindjen, Pashkët dhe data të tjera që lidhen me Nënë Terezën
- Të ngritet një sistem licencimi ose tarifë për shitësit nëpër festivale me qëllim të krijimit të bazës tatimore në mbështetje të zhvillimit lokal
- Të krijohen atraksione turistike tjera për të tërhequr numër më të madh të vizitorëve gjatë fundjavave, siç janë shtigjet nëpër pyje dhe përgjatë përrenjve

- Të bëhet konservimi i një shtëpie tradicionale që të shërbejë si pansion apo hotel me qëllim të tërheqjes së vizitorëve për periudhë më të gjatë
- Të krijohen një brend lokal dhe prodhime lokale që mund të shërbejnë si ndihmesë për formimin e një identiteti të dallueshëm
- Të shikohen mundësitë e prodhimit në shkallë të vogël dhe ripërdorimit të mundshëm të ish-fabrikës së tekstit për prodhim apo përpunim të produkteve bujqësore

### Mjedisi

- Të pastrohen shtretërit e lumenjve, rruga dhe shtigjet nga mbeturinat dhe fermerët të edukohen për atë se kujdesi për natyrën përreth shton bukurinë natyrore të fshatit dhe inkurajon vizitat
- Të ndërtohet një shteg alternativ këmbësorësh për t'iu qasur fshatit përgjatë rrjedhës së përroit, si edhe shtigje tjera për ecje në natyrë në rrethinën e fshatit
- Të krijohen vendkampingje përgjatë shtegut në kodrat përreth me pamje nga fshati, kisha dhe bukuritë natyrore
- Të zvogëlohet ndikimi negativ i parkingut të madh të asfaltuar që ndodhet në hyrje të fshatit
- Të përmirësohen elementet kyçe infrastrukturore, furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimi, kanalet e kullimit dhe mbledhja e mbeturinave

### Kultura

- Të konservohen elementët kryesorë të arkitekturës popullore, shtëpitë me rëndësi, shtallat dhe objekti i tregut
- Të përmirësohen lidhjet midis fshatit dhe Kishës Katolike si palë e rëndësishme
- Të krijohen lidhje të ngushta me projektin e ardhshëm për krijimin e shtegut “Nënë Tereza” nga Maqedonia Veriore
- Të ngriten kapacitetet e komunitetit për të ruajtur dhe për t'u kujdesur për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin

/14

Këto rekomandime janë nxjerrë mbi baza të informatave që janë mbledhur gjatë punëtorisë dyjavore të mbajtur në muajt qershor-korrik 2019. Kapitujt e mëposhtëm japin pasqyrë më të hollësishme të çështjeve/sfidave dhe të informatave përcjellëse që kanë shpie në nxjerrjen e këtyre rekomandimeve. Veç këtyre rekomandimeve, duhet të punohet më tej në këtë temë - me përfshirjen e një game të gjerë të hisedarëve dhe të akterëve (të mundshëm) të ardhshëm - për përgatitjen e një plani të plotë për zhvillimin rural të Letnicës, duke përfshirë këtu dhe planin e veprimit si instrument për zbatimin e planit zhvillimor.

# KREU I - HYRJE

Fshati i vogël i Letnicës ndodhet në pjesën jugore të Kosovës në Komunën e Vitisë. Moshë mesatare e popullsisë është mbi 65 vjeç, bujqësia është në shkallë të vogël dhe marginale, dhe në fshat kanë mbetur numër shumë i vogël banorësh të cilët sigurojnë mbijetesën nga pensionet. Fshati ka pësuar shumë gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë dhe më pas gjatë konfliktit në Kosovë. Familjet kroate të Kosovës të cilat ishin aty për kohë të gjatë dhe përbënin shumicën e popullsisë së fshatit ikën, ndërsa fabrika e tekstilit, punëdhënësi kryesor në fshat, u mbyll. Viteve të fundit fshatin e kanë lëshuar shumë të rinj në kërkim të punës apo për arsim në qytetin e afërt të Gjilanit apo në Prishtinë. Kjo ka vënë në pikëpyetje mbijetesën e fshatit.

Ndonëse gjendja duket të jetë dëshpëruese, ende ka shpresë. Fshati dhe rrethinat e tij krijojnë një peisazh idilik, me shtëpitë e plevicat me tjegulla të kuqe të vendosura në një grykë malore që njëherësh është dhe pikëtakim i dy përrënjeve. Kohëve të fundit në këtë fshat është restauruar një mulli, ndërsa një restorant vazhdon të shërbejë gatime tradicionale kroate nga prodhimet vendore. Fshati ka marrë një infuzion tejet të nevojshëm të popullsisë nga shteti fqinj i Maqedonisë së Veriut gjatë trazirave të atjeshme, ndërsa familjet që kanë lëshuar fshatin nuk e lënë në harresë dhe shpesh kthehen për fundjava ose pushime. Vizitorë të tjerë vijnë gjithashtu nga Prishtina, për t'i ikur qyteti dhe për të shijuar malet dhe traditat rurale. Nuk duhet harruar trashëgimia e Nënë Terezës së Kalkutës. Ishte mu në kishën e Letnicës ku ajo pranoi thirrjen për t'u bërë murgeshë kur ishte vajzë e vogël. Çdo vit në muajin gusht mijëra besimtarë të devotshëm zbresin në fshat për disa ditë gjatë Kremtës së Zonjës së Madhe për të kryer ritet e tyre, ku shumë syresh udhëtojnë distanca prej mijëra kilometrash. Megjithatë është pikëpyetje nëse këto avantazhe mjaftojnë për ta siguruar vazhdimësinë e fshatit. Duhet ndërmarrë veprime, të konservohen objektet kyçe dhe, ç' është më e rëndësishmja, duhet të krijohet një plan i zhvillimit rural.

Situata e pasigurt e fshatit Letnicë, bashkë me rëndësinë kulturore të tij si vend i pelegrinazhit fetar, arkitekturës popullore dhe kontekstit natyror, e kanë shtyrë Fondacionin Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) që të realizojë disa punëtori "Heritage Lab" dhe të hartojë këtë raport fillestar në mbështetje të përpjekjeve për zhvillim. Ky raport bazohet në informatat e mbledhura gjatë punëtorisë zhvillimore të mbajtur në verën e vitit 2019 me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Në këto aktivitete janë identifikuar disa çështje të rëndësishme vendimtare për sa i përket qëndrueshmërisë së fshatit, përfshirë këtu popullatën në plakje, mosekzistimin e bazës ekonomike, mangësitë në infrastrukturën bazike, si dhe degradimin e gjithmbarshëm të trashëgimisë kulturore. Raporti bën një përvijim themelore të gjendjes aktuale për ta kuptuar më mirë fshatin, avantazhet dhe disavantazhet e tij, duke dalë në fund me rekomandime për një plan të plotë të zhvillimit rural.



Figura 9 – Rrjedha e rrëmbyeshme e kanalit që furnizon mullirin e restauruar së fundi.

Foto: Rand Eppich



## HISTORIA E LETNICËS

Që nga Mesjeta, Malet e Karadakut në Gadishullin qendror të Ballkanit kanë qenë burim i rëndësishëm i mineraleve, përfshirë plumbin, zinkun dhe argjendin.<sup>1</sup> Shumë qendra minerare u zhvilluan, duke joshur minatorë me përvojë nga i gjithë rajoni dhe tregtarët nga qendrat tregtare bregdetare si Dubrovniku (Ragusa). Trashëgimia e tyre jeton në fshatra si Shashare, (Sasar domethënë Saksonë), Stubëll e Epërme dhe Letnicë. Pasardhësit e këtyre saksonëve, kroatët e Kosovës, si dhe minatorët shqiptarë të Kosovës, gëzuan prosperitetet.<sup>2</sup> Begatia e tyre u reflektua edhe në shtëpitë dhe kishat e tyre të bukura.

Kisha Katolike e Letnicës (*Te Ngriturit e Zojës së Bekuar në qiell / Zoja e Cernagores*) është më e rëndësishmja nga këto struktura. Të dy kambanarët e kishës duken menjëherë që në hyrje të fshatit, pasi ndërtesa ngrihet mbi një kodër dhe varet mbi fshatin e përgjumur. Kisha e parë mbase është ndërtuar këtu në shekullin XIV, në një kohë kur Letnica duhet të ketë qenë një qendër minerare e vogël, por në lulëzim e sipër. Më 1584, të dhënat osmane paraqesin rreth 500 familje të krishtera që

1. Shih: *Minierat dhe vendburimet minerare në Kosovë*, <https://www.kosovo-mining.org/mineral-resources/mineral-deposits/?lang=en> (qasur më 4.02.2020), shih edhe Vukovic, M., Weinstein, A., "Kosovo mining, metallurgy, and politics: Eight centuries of perspective" (Minierat, metalurgjia dhe politika e Kosovës: Tetë shekuj perspektivë), në *Journal of the Minerals, Metals & Materials Society* (Revista e Shoqatës së Mineraleve, Metaleve e Materialeve) 54 (5)(maj 2002), ff. 21-24.

2. Warrander, G., Knaus, V., *Kosovë* (Chesham/Bucks: Bradt Travel Guides, 2010), f. 253.

jetojnë në zonë<sup>3</sup>, e me popullsi të tillë, një faltore formale ishte thelbësore. Thuhet që Zoja është shfaqur tri herë në Letnicë, duke u bërë thirrje fshatarëve të ndërtonin një kishë. Në vitin 1737, të dhënat arkivore tregonin se kishës iu bënë riparime të mëdha, por u rindërtua më pas nga njëqind vjet më vonë, më 1866. Kjo ndërtesë u dëmtua rëndë gjatë një tërmeti, ndërsa ndërtimi i strukturës së tanishme filloi më 1928, si dhe përfundoi më 1934. Brenda kishës gjendet e shenjta 300-vjeçare Zoja e Cernagores (quajtur Nëna e Zotit - Crnogorska), ndërtuar nga druri i katranosur, nga ku e ka marrë edhe emrin, e cila sipas besimeve lokale mund të ndihmojë çiftet pa fëmijë, si dhe nderohet njëlloj nga katolikët, të krishterët ortodoksë, dhe myslimanët. Një tjetër legjendë që rrethon “Zojen e Cernagores” është edhe udhëtimi i saj mrekulli nga vendndodhja e saj origjinale në Shkup përmes Malit të Karadakut e deri në kishën e Letnicës, si dhe mbijetesa e saj gjatë tërmetit, përkundër shkatërrimit të gjithë ndërtesës përreth saj.

Mu në këtë kishë, “në vitet e 20-ta, një vajzë e re e quajtur Agnesë Gonxhe Bojaxhiu, u nis për një pelegrinazh në Letnicë... ku ajo mori thirrjen e saj për jetë fetare. Disa vite më vonë, ajo nisi një udhëtim jetësor, për të ndihmuar të sëmurët dhe të varfrit kudo në botë..”<sup>4</sup> Ajo njihet më mirë si Nënë Tereza e Kalkutës, si dhe u shenjtërua më 4 shtator 2016, në përvjetorin e vdekjes së saj.

Gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, komuniteti i vogël kroat i Kosovës që jetonte në Letnicë kërcënohej përditë e më shumë. Rrjedhimisht, shumica e kroatëve të Kosovës u larguan, si dhe u inkurajuan nga Republika e re e Kroacisë së atëhershme të vendoseshin në vendet e braktisura nga serbët në Sllavoninë Perëndimore. Sot, një numër shumë i vogël i kroatëve të Kosovës qëndrojnë në Letnicë, bashkë me disa fshatra të tjerë afër.

Çdo vit më 14-15 gusht, kisha organizon festivalin dy-ditor kushtuar Festës së Zojës së Bekueme. Kjo ngjarje tërheq mijëra besimtarë, përfshirë edhe shumë kroatë të Kosovës që janë larguar nga Kosova dekada më parë. Shumë nga të devotshmit ecin deri në Letnicë këmbëzbathur për shumë kilometra, ndërsa të tjerët bartin gurë. Për më tepër, edhe shumë të tjerë nga jashtë vendit marrin pjesë në Festë.<sup>5</sup> Gjatë festivalit, i gjithë fshati bëhet një vend kampingu dhe pikniku, çadrat ngriten në kopshtin e kishës dhe në fushat përreth. Ata që rezervojnë mjaft përpara mund të marrin ndonjërin nga dhomat e pakta në bujtinat e ndërtuara enkas pranë kishës.<sup>6</sup>

---

3. Po aty.

4. Shih: Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Ringjallja e trashëgimisë së Letnicës – gjurmët e Nënës Terezë të Kalkutës* (17 korrik 2019), <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/425873> (qasur më 04.02.2020).

5. Për shembull, pjesëtarët e KFOR-it, shih Smith N., *Pelegrinazhi drejt Zojës së Cernagores*, (3 shtator 2009), [https://www.army.mil/article/26966/pilgrimage\\_to\\_the\\_black\\_madonna](https://www.army.mil/article/26966/pilgrimage_to_the_black_madonna) (qasur më 13.02.2020).

6. Osmani, S., "Mijëra njerëz vizitojnë fshatin e Kosovës", në *Balkan Insight*, 2011, <https://balkaninsight.com/2011/09/19/thousands-revisit-kosovo-village-where-mother-teresa-heard-call/> (qasur në 13.02.2020).

*Figura 10 – Kisha Katolike e Letnicës - Te Ngriturit  
e Zojës se Bekuar në qiell/Zoja e Cernagores.  
Foto: Rand Eppich*



## PËRKUFIZIMI I ZHVILLIMIT

Zhvillimi më parë nënkuptonte ekskluzivisht zhvillimin ekonomik, rritjen industriale dhe nxjerrjen e resurseve. Sidoqoftë sot, përkufizimi është shumë më ndryshe, më i gjerë dhe priret të përfshijë nevojat sociale krahas atyre ekonomike. Kombet e Bashkuara theksojnë "zhvillimin njerëzor", matur me jetëgjatësinë, arsimimin e të rriturve, qasjen në tre nivele të shkollimit, si dhe të ardhurat mesatare të njerëzve. Nocioni i zhvillimit njerëzor - siç definohet me Indeksin e Zhvillimit Njerëzor (HDI), i cili u prezantua nga UNDP më 1991 - përfshin të gjitha aspektet e mirëqenies së individëve, që nga gjendja e tyre shëndetësore e deri tek liria e tyre ekonomike.<sup>7</sup> Përputhshmëria midis zhvillimit dhe konservimit më në fund ka filluar të ndodhë. UNESCO, në fund të shekullit XX, deklaroi se bota jo vetëm që po përballet me sfida ekonomike, sociale, apo mjedisore - krijimtaria, njohuria, diversiteti dhe bukuria janë bazat për dialog mbi paqen dhe përparimin, e këto vlera janë të lidhura pandashëm me zhvillimin dhe liritë e njeriut.<sup>8</sup> Tri Shtyllat e Zhvillimit të Qëndrueshëm thjesht nuk kanë mundur të reflektojnë gjithë kompleksitetin e shoqërive. UNESCO, paralelisht me Samitin Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm, bën thirrje në Deklaratën Hangzhou për përfshirjen e kulturës si Shtyllë e katërt në modelin e zhvillimit të qëndrueshëm, pasi që kultura përfundimisht formëson atë që nënkuptohet me zhvillim, si dhe përcakton se si veprojnë njerëzit në botë.<sup>9</sup>

Përmirësimi i cilësisë së jetës në komunitete të largëta lidhet drejtpërdrejt me mbijetesën dhe forcimin e kulturës së tyre, trashëgimisë së ndërtuar dhe peizazheve. Konservimi i këtyre hapësirave krijon frymën e shtëpisë, ndërsa ndërlidh gjeneratat, duke përfshirë diasporën, për t'i lidhur të gjitha me të kaluarën e tyre dhe për të forcuar ndjenjën e përkatësisë. Por këto vende unike dhe vlerat e tyre janë jashtëzakonisht të brishta, kështu që duhen mbrojtur. Zhvillimi i suksesshëm rural ndihmon në këtë mbrojtje dhe është një proces që synon të përmirësojë cilësinë e jetës, duke ndihmuar njerëzit të vendosin prioritetet e tyre përmes përfshirjes efektive dhe gjithëpërfshirëse, përmirësimit të kapacitetit lokal, shërbimeve sociale, por edhe ruajtjes së kulturës. Sidoqoftë, zhvillimi rural që merr parasysh kulturën, mjedisin e ndërtuar ose peizazhin ka gjasë të rrezikojë komunitetin, vlerat dhe qëndrueshmërinë e tij.<sup>10</sup> Ky botim përshkruan përvojat dhe përpjekjen e ekipit Heritage Lab në ndihmë të komuniteteve rurale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe peizazheve së tyre.

7. Shih Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), *Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (HDI)* <http://hdr.undp.org/en/content/human-development-index-hdi> (qasur më 13.02.2020).

8. Shih UNESCO, *Kultura: e ardhmja urbane; raport global mbi kulturën për zhvillim të qëndrueshëm urban* (Paris: UNESCO, 2016), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000245999> (qasur më 13.02.2020).

9. UNESCO, *Deklarata Hangzhou: Vënia e kulturës në zemër të politikave të zhvillimit të qëndrueshëm. Miratuar në Hangzhou, Republika Popullore e Kinës, më 17 maj 2013* (Paris: UNESCO, 2013), <http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CLT/images/FinalHangzhouDeclaration20130517.pdf> (qasur më 13.02.2020).

10. Eppich, R., *Cultural Heritage, Landscape and Rural Development Good Practice, Methodology, Policy Recommendations and Guidelines for Rural Communities (Trashëgimia Kulturore, Peizazi dhe Zhvillimi Rural: Praktikata e mira, Metodologjia, Rekomandimet për Politika, si dhe Udhëzime për Komunitetet Rurale)* (2014, INTERREG IVC, Bashkimi Evropian dhe Projekti HISTCAPE).



Figura 11 – Zhvillimi mbështet banorët, por edhe vetë fshatin. Foto: Rand Eppich

### Zhvillimi njerëzor

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim definon më tutje zhvillimin me mbiemrin “njerëzor” të shtuar:

*“Zhvillimi njerëzor ka të bëjë me rritjen e pasurisë së jetës njerëzore, jo vetëm pasurinë e ekonomisë në të cilën jetojnë qeniet njerëzore. Është qasje që fokusohet tek njerëzit dhe mundësitë e zgjedhjet e tyre”<sup>11</sup>*

si dhe është përkufizuar në tri kategori kryesore:

**Njerëzit:** Rritja e të ardhurave shihet si mjet për zhvillim, jo si qëllim në vetvete.

**Mundësitë:** Kjo nënkupton zhvillimin e aftësive të njerëzve dhe ofrimin e mundësisë për t'i shfrytëzuar ato.

**Zgjedhja:** Ka të bëjë me ofrimin e mundësive për njerëz, e jo insistimin që ato të shfrytëzohen gjithsesi. Procesi krijon një mjedis për të mundësuar betejën drejt përmbushjes së potencialit të plotë të personit.<sup>12</sup>

### Zhvillimi social

Zhvillimi social është përkufizuar si një sërë veprimesh dhe si

*“një proces i ndryshimit shoqëror të planifikuar, dizajnuar për të promovuar mirëqenien e popullatës si një e tërë, në kontekstin e një procesi dinamik, shumëdimensional të zhvillimit.”<sup>13</sup>*

Kjo formë e zhvillimit është e rëndësishme, ashtu që banorët të mund të përfitojnë nga efektet pozitive kolektive të pjesëmarrjes ose “kapitalit shoqëror”, përfshirë këtu edhe “tiparet e organizimit shoqëror, siç janë rrjetet, normat dhe besimi që lehtësojnë bashkërendimin dhe bashkëpunimin për përfitime të ndërsjella.”<sup>14</sup>

11. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP): *Për zhvillimin njerëzor: Çfarë është zhvillimi njerëzor?* (2018), <http://hdr.undp.org/en/humandev> (qasur më 13.02.2020).

12. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP): *Për zhvillimin njerëzor: Çfarë është zhvillimi njerëzor?* (2018), <http://hdr.undp.org/en/humandev> (qasur më 13.02.2020).

13. Midgley, J., *Social Development Theory and Practice (Teoria dhe Praktika e Zhvillimit Social)* (Londër: Sage, 2013) f. 13.

14. Putnam, R., “The Prosperous Community: (Komuniteti i begatë) Social Capital and Public Life” (Kapitali Social dhe Jeta Publike), tek: *The American Prospect (Perspektiva Amerikane)* 4 (13, 19 dhjetor 2001), ff. 35–42.

Pesë faktorë kyçë janë identifikuar për zhvillim social të komuniteteve:<sup>15</sup>

1. Një ndjenjë e vendit dhe përkatësisë
2. Mundësi për aktivitete kolektive
3. Mundësi për të ndërtuar rrjete sociale
4. Dizajn që inkurajon ndërveprimin
5. Inkurajimi i sjelljes pro mjedisit

Këta faktorë kyçë janë të rëndësishëm kur propozojnë të përmirësojnë zhvillimin shoqëror dhe ta arrijnë atë përmes veprimeve. Për ta bërë këtë, duhet të kuptohet situata aktuale dhe ngeçjet në zhvillimin shoqëror.

## ARSYEJA, METODOLOGJIA, STRUKTURA

Futja e kulturës brenda zhvillimit shënoi një ndryshim të rëndësishëm. Pesha e kulturës dhe identitetit ishte proces.

*"Zhvillimi është më pak zënie e hapit e imitim, e në vend të zhvillimit si proces gjithëpërfshirës ku akomodohen botëkuptime të ndryshme - që ky theks në kulturë mund të jetë sfida më e madhe në ripërkufizimin e zhvillimit".<sup>16</sup>*

Por pse duhet të ruhet fshati i vogël i Letnicës? Vetëm për shkak të kulturës së tij? Pse duhet që ky vend të merret parasysh? Kjo pyetje duhet të parashtrahet për të arsyetuar vëmendjen dhe resurset e mundshme që mund të drejtohen drejt fshatit. Përgjigja e parë e dukshme është se ky është vendi, ku një fëmijë i vogël, Nënë Tereza nga Kalkuta, gjeti frymëzimin dhe ia kushtoi jetën e saj shërbimit të tjerëve. Sidoqoftë, kisha dhe kompleksi i saj mund të mbijetojnë dhe të funksionojnë mjaft mirë, edhe pa fshatin. Pelegrinët do të vinin akoma, me ose pa objekte apo komunitetin që rrethon kishën. Shumë pelegrinë sot nuk futen në vendbanimin e vogël, por shkojnë direkt në destinacionin e tyre. Në fakt, strukturat më së miri të ruajtura në fshat janë ato që mirëmbahen nga Kisha Katolike.

---

15. Fondacioni Young, *Understanding neighbourliness and belonging (Të kuptuarit e fqinjësisë dhe përkatësisë)*(2008) f. 2, <https://youngfoundation.org/publications/understanding-neighbourliness-and-belonging/> (qasur më 17.02.2020).

16. Hettne, B. *Human Values and Global Governance (Vlerat njerëzore dhe qeverisja globale): Studies in Development, Security and Culture, Volume (Studime në zhvillim, siguri dhe kulturë, vëllimi)* (Basingstoke: Palgrave-Macmillan, 2008), p. 697; Rojas, C., "International political economy/development otherwise" (Ekonomia politike ndërkombëtare/zhvillimi ndryshe), tek: *Globalizations* 4 (4)(2007), ff. 573-587.

Por, humbja e fshatit do të nënkuptonte humbjen e kontekstit që rrethon vendin e pelegrinazhit. Kisha dhe "Zoja e Cernagores" ekzistojnë vetëm për shkak të njerëzve, besimeve të tyre dhe fshatit. Humbja e fshatit do të dobësonte ndikimin tek pelegrinët vizitues, e ata duhet ta kenë mundësinë ta përjetojnë këtë vend frymëzimi, si Nënë Tereza. Vizitorët duhet të kenë mundësinë të bisedojnë me fshatarët, të hanë me ta dhe të jetojnë mes tyre. Humbja e fshatit do t'i privonte pelegrinët nga përvoja e Letnicës si një peizazh kulturor me vlera shpirtërore.

Përtej kontekstit fetar, nëse Letnica nuk arrin të ruhet, edhe një aspekt i rëndësishëm multikulturor i Kosovës do të humbej, duke pasur parasysh bashkëjetesën e tij shembullorë paqësore midis komuniteteve të ndryshme përgjatë shumë shekujve. Letnica është kujtesë e gjallë e historisë në Kosovë, që mund të bëhet përvojë për gjeneratën e ardhshme.

Përfundimisht, vetë fshati karakterizohet nga një mjedis harmonik. Kullat e gurit dhe hambarët e vendosur afër, bashkë me çatitë e tyre me tjegulla të kuqe, që gati puqen mes vete, janë kënaqësi. Natyra që rrethon fshatin kontribuon po ashtu në këtë bukuri, me pyje me rritje madhore në male dhe përrockë të kthjellët që e përshkon. Duke qenë vetëm një orë larg qytetit të Prishtinës, Letnica mund t'u ofrojë banorëve urbanë një ikje, një largim të përkohshëm nga jeta e qytetit.

Dy punëtorit verore në Letnicë, të ndara në tre ekipe, njëri që punon për konservimin fizik, një tjetër për interpretimin dhe hulumtimin, si dhe një tjetër që hulumton zhvillimin, kanë formësuar metodologjinë. Janë mbajtur edhe ligjërata, hulumtime të shembujve të tjerë, intervista në komunitet, vëzhgime dhe diskutime të shumta. Është kryer edhe një analizë SWOT (pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet) për çështjet e përgjithshme, por edhe përshkrimi i trungut të problemit/zgjidhjes. Ky raport është rezultat i seminarit veror, si dhe është strukturuar në tre kapituj: Kapitulli I është kjo hyrje, Kapitulli II përshkruan fshatin në aspektin social dhe ekonomik, si dhe përfshin të dhëna të mbledhura gjatë Heritage Lab, si dhe analiza që përfshin edhe atë SWOT; në fund, Kapitulli III propozon një plan zhvillimi dhe veprimi, pasuar me përfundimet dhe rekomandimet. Shtojca përmban harta, bibliografinë dhe informata për punëtorinë e Heritage Lab.

*Figura 12 – Një nga shumë hambarët vernakularë, ndërtuar me gurë fushe dhe trarë lokalë, të cilët kontribuojnë për të krijuar trashëgiminë e Letnicës.  
Foto: Rand Eppich*

# KAPITULLI II - TË KUPTUARIT E LETNICËS

## GJENDJA SOCIALE

### Demografia

Vetëm 32 kroatë të moshuar të Kosovës jetojnë ende në fshat. "Shumë sosh janë të vejë, jetojnë të vetëm në shtëpi që janë në gjendje tejet të keqe, shpesh mezi qëndrojnë në këmbë.<sup>17</sup> Këta shpirtra të qëndrueshëm janë të vetmit trashëgimtarë të mbetur të kolonëve të parë që kishin ardhur për të gërmuar këto male të largëta disa qindra vjet më parë. Shumë nga familjet kroate të Kosovës janë larguar gjatë luftës dhe shpërbërjes së Jugosllavisë në vitet 1990, si dhe janë zhvendosur gjetkë në Kroaci.<sup>18</sup> Deri më tani, katër kroatë të Kosovës janë kthyer në Letnicë që nga viti 1999.<sup>19</sup> Atyre iu bashkuan, më 2001, edhe familje katolike shqiptare. "Afro 200 shqiptarë etnikë nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë zaptuan shtëpitë e braktisura nga kroatët e Kosovës gjatë konfliktit të vitit 2001 në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, e që kanë mbetur të tillë që nga ajo kohë".<sup>20</sup> Sipas disa përllogaritjeve, ka afro 200 shqiptarë të Kosovës, të grupmohave të ndryshme, që jetojnë aktualisht në fshat.<sup>21</sup> Përmes vëzhgimeve në terren dhe intervistave, është vërejtur që këto grupe kryesore kanë ndërveprim të kufizuar, duke rezultuar në jo një por dy bashkësi të vogla që thjesht ekzistojnë së bashku në të njëjtin vend. Ardhja e shqiptarëve të Maqedonisë gjatë konfliktit të vitit 2001 "çoi në tensione me kroatët rezidentë të Kosovës dhe konflikte lidhur me uzurpimin e pronave bujqësore dhe banesore, të cilat këto komunitete nuk kanë arritur të zgjidhin".<sup>22</sup>

17. Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë: Komunitet i Cënueshëm* (tetor 2011), f. 4, <https://www.osce.org/kosovo/83789?download=true> (qasur më 17 shkurt 2020)

18. Šiljković, Ž., Glamuzina, M., "Janjevo and Janjevci – from Kosovo to Zagreb (Janjeva dhe janjevasit - nga Kosova në Zagreb)", tek *Geoadria* (Zadar: Universiteti i Zadrës, Departamenti i Gjeografisë, 2004), 9/1, faqe 89-109.

19. Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë: Komunitet i Cënueshëm* (Tetor 2011), f. 4

20. Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë: Komunitet i Cënueshëm* (Tetor 2011), ff. 4-5

21. Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Profilat e Komuniteteve të Kosovës, Raport* (Prishtinë: OMIK, 2010). Kjo shifër ishte e vështirë të vërtetohej, edhe pse një numër i njerëzve në fshat e përmendin në intervistat e tyre.

22. Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë: Komunitet i Cënueshëm* (Tetor 2011), f. 4.





Figura 13 – Shkolla fillore "Mikel Tarabulluzi" mbetet e hapur për pak fëmijë. Foto: Rand Eppich

### Kujdesi shëndetësor

Siç është raportuar nga OSBE-ja, "qasja në shërbime shëndetësore është e kufizuar për shkak të mobilitetit të kufizuar të komunitetit, mungesës së transportit publik adekuat dhe distancave të gjata deri në institucionet më të afërta shëndetësore",<sup>23</sup> të cilat ndodhen 8 kilometra larg në komunën fqinje. Në të kaluarën, Kisha Katolike ofronte shërbime bazike shëndetësore vullnetarisht, si dhe ka pasur një program, rreth dhjetë vjet më parë, për rehabilitimin e klinikës lokale. Për sëmundje më të rënda, pjesëtarët e komunitetit duhet të udhëtojnë për në Prishtinë ose edhe më larg.<sup>24</sup> Është kuptuar që nuk shërbime shëndetësore mobile, apo klinikë të rregullt aktualisht në dispozicion.

### Arsimi

Sipas Planit Zhvillimor Komunal 2010-2020 të Vitisë (*Plani Zhvillimor Urban i Vitisë 2010 - 2015*)<sup>25</sup> fshati Letnicë ka 51 fëmijë. Sidoqoftë, ekziston vetëm një shkollë fillore, "Mikel Tarabulluzi", si dhe është pjesë e së njëjtës shkollë në Stubëll të Epërme, një fshat aty pranë. Bazuar në intervistat në terren (të detajuara si më poshtë), kryer gjatë punës të trashëgimisë kulturore, shkolla ofron arsim vetëm për klasat 1-4, ndërsa për vazhdimin e shkollimit për fëmijët më të mëdhenj, ata duhet të udhëtojnë në një fshat tjetër. Ndërtesa e shkollës është e vendosur në një kodër mbi fshat, si dhe është ndërtuar gjatë periudhës së Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë. Ajo është e ndërtuar mirë me beton-arme, ku vetëm një pjesë e vogël në katin e poshtëm aktualisht shfrytëzohet. Nuk ka fushë loje apo gjëra të tilla. Prania e fëmijëve është inkurajuese pasi ky është aspekt i rëndësishëm i jetës rurale dhe zhvillimit shoqëror. Funkionimi i vazhdueshëm i kësaj shkolle është kritik sepse pa të, familjet e reja nuk mund të inkurajohen të rivendosen në fshat.

23. Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë: Komunitet i Cënueshëm* (Tetor 2011), f. 5

24. Bazuar në intervista; një murgeshë punon si infermiere vullnetare.

25. Komuna e Vitisë, *Plani Zhvillimor urban i Vitisë (2010 - 2015)*, (Viti: Komuna e Vitisë - Drejtoria për Urbanizëm, 2010), <https://kk.rks-gov.net/viti/wpcontent/uploads/sites/32/2010/12/Plani-Zhvillimor-Urban.pdf>

## Intervistat

Duke i pasur parasysh rrethanat në Letnicë, u vendos që të zhvilloheshin intervista të strukturuar por me pyetje të hapura për të mbledhur të dhëna për gjendjen socio-ekonomike të banorëve, mënyrat e udhëtimit, profesionet, nivelin e shkollimit, dhe gjendjen aktuale të jetesës. Bazuar në disa intervista fillestare provuese, Trashëgimia Botërore Pa Kufij përpiloi një pyetësor për të shërbyer si udhëzues për intervistat e ardhshme dhe e caktoi një ekip për t'i zhvilluar intervistat me anëtarët e komunitetit.

Pyetësi konsistonte në pyetjet vijuese:

1. Sa anëtarë të familjes keni?
2. Çfarë niveli arsimit kanë familjarët tuaj?
3. Sa anëtarë të familjes tuaj janë të punësuar?
4. A do të punonit në Letnicë nëse do t'ju jepej mundësia? Çfarë pune do të bënit?
5. Si udhëtoni jashtë Letnicës?
6. A merreni me bujqësi e blegtori?
7. Çfarë ju nevojitet në Letnicë?
8. A ju ka shkuar ndonjëherë ndërmend largimi nga fshati?
9. A e dini për çfarë arsye kanë emigruar kroatët e Kosovës në Letnicë?

Fillimisht, ideja ishte të intervistohen të gjithë banorët, por për shkak të kohës dhe resurseve të kufizuara, ekipi arriti të zhvillonte 13 intervista formale dhe 24 joformale. Megjithatë, ky proces bëri të mundur që fshatarët të njoftoheshin me projektin, qëllimin dhe anëtarët e tij. Rrjedhimisht, u zhvilluan shumë bashkëbisedime joformale gjë që ia mundësoi ekipit mbledhjen e informatave. Këto intervista, formale e joformale, i dhanë drejtim planit zhvillimor.

Pasqyra e shkurtër e informacioneve të mbledhura përfshinë:

- Niveli arsimor, mesatarisht, është në nivel të shkollës fillore
- 95% e respondentëve me familje punojnë jashtë fshatit
- Në pyetjen se a do të dëshironit të punonit në fshat, shumica u përgjigjen po
- Shumica shprehën interesim në punën bujqësore, meqë shumica e tyre i punojnë tokat apo merren me blegtori për konsum, pra nevojat e tyre shtëpiake
- Nuk ka transport publik të asnjë lloji, dhe shumica mbështetët e varën nga transporti privat
- Si nevoja të menjëhershme bazike përmenden uji i pijshëm, një shkollë fillore (klasat 1-9) dhe një shitore apo vetëshërbim më i madh
- Shumica e njerëzve të intervistuar do ta merrnin parasysh largimin, për shkak të mungesës së nevojave të sipërpërmendura. Megjithatë, shumica e tyre do të qëndronin në rast se do të përmirësoheshin kushtet e jetesës

Intervista gjithashtu nxori në pah që edhe ata pak kroatë të mbetur të Kosovës (fatkeqësisht vetëm katër kroatë të Kosovës morën pjesë në anketë) ishin shumë mirë të informuar për historinë: rreth 2000 paraardhës të tyre erdhën në rajon rreth 800 vjet më parë për të punuar si minatorë, dhe me kalimin e kohës krijuan familje, themeluan fshatin dhe e ndërtuan kishën e tyre. Kjo sqaron pse, edhe përkundër të gjitha gjasave, ata këmbëngulin të qëndrojnë dhe të investojnë në mbajtjen e fshatit gjallë. Në anën tjetër, intervistat zbuluan që familjet shqiptare të ardhura më vonë nuk janë aq mirë të informuara për historinë e fshatit. Megjithatë, shumica nga të dyja grupet dëshirojnë të mbesin në fshat nëse përmirësohen kushtet e jetesës. Më e rëndësishmja, shumica janë të vullnetshëm të punojnë për përmirësimin e fshatit. Fatkeqësisht, çështjet lidhur me turizmin nuk u përfshinë në anketë. Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm në fshat është pozitiv në drejtim të festivaleve fetare dhe se turizmi duhet shtuar, gjegjësisht rritur në mënyrë që të përmirësojë ekonominë.

## Gjendja ekonomike

Zhvillimi ekonomik është një tërësi programesh që ndihmojnë në krijimin, ruajtjen dhe zgjerimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e një baze të qëndrueshme tatimore.<sup>26</sup> Gjatë 20 viteve të fundit, ka pasur një theks në rritje posaçërisht në zhvillimin ekonomik lokal (ZHEL). Siç nënkuptohet nga emri, ai i jep një rëndësi të veçantë aktiviteteve ekonomike lokale për t'u përballur me ndikimet e globalizmit dhe për të ndërtuar mbi përparësitë unike lokale. Ai përfshin një sërë aktiviteteve, duke përfshirë këtu planifikimin dhe përfshirjen e komunitetit. Sipas UN-Habitat, "ZHEL mund të çojë në zgjidhje ekonomike që i 'përshtaten' zonave lokale-domethënë, zhvillim që bazohet në pasuritë dhe forcat lokale, që përfshinë njerëzit lokalë dhe ndërton kapacitete, dhe që ka besimin dhe mbështetje më të madhe nga komuniteti."<sup>27</sup>

Trashëgimia kulturore është njohur prej kohësh nga agjenci të shumta zhvillimi si diçka që ka një avantazh konkurrues për t'u përdorur për zhvillimin ekonomik lokal. Në një ngjarje të organizuar nga Banka Botërore në vitin 2012, Joshi - Ghani deklaroi se

*"është e rëndësishme të kuptohet se si qytetet [ose fshatrat] tërheqin njerëz të aftë dhe industri për të krijuar vende pune dhe çfarë roli luajnë ato në rritjen ekonomike. Prandaj, gjetja e lidhjes midis pasurive të trashëgimisë kulturore dhe krijimit të vendeve të punës ndihmon shumë."*<sup>28</sup>

26. Këshilli Ndërkombëtar për Zhvillim Ekonomik (IEDC): vështrim në IEDC, <https://www.iedconline.org/web-pages/inside-iedc/iedc-at-a-glance/> (vizituar më 17.02.2020).

27. Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat), *Zhvillimi Ekonomik Lokal në Praktikë - Vegël për praktikuesit e ZHEL* (Nairobi 2013), f. 1, <https://unhabitat.org/local-economic-development-in-practice> (vizituar më 17.02.2020).

28. Banka Botërore, *Ekonomia e të qenurit unik*, <http://www.worldbank.org/en/news/feature/2012/09/26/economics-uniqeness-embracing-cultural-heritage> (vizituar më 20.02.2020).

Duke e pasur parasysh Festën e Zonjës së Bekuar të Letnicës, praninë fizike të kishës, dhe “Shtatoren e Zonjës së Zezë”, bashkë me lidhjen që ka me Nënë Terezën, ky është një prej aspekteve më kritike të ZHEL. Fatkeqësisht, fshati nuk ka përfitime ekonomike që burojnë nga këto pasuri kulturore. Nuk ka akomodim për pelegrinët, festivali është shumë i shkurtër dhe shitësit vijnë nga gjetkë. Kjo situatë duhet të ndryshojë.

## Industria

Nuk ka asnjë industri prodhuese në Letnicë. Fabrika e tekstit, e cila u ndërtua në vitin 1986, ka punuar në prodhim të uniformave dhe këpucëve të punëtorëve me kapacitete të plota deri në vitin 1999. Ajo pushoi së funksionuari për shkak të konfliktit dhe është mbyllur që nga ajo kohë. Në vitin 2007, fabrika u privatizua<sup>29</sup> dhe pasuritë e luajtshme, kryesisht makinat qepëse industriale, u transferuan në një entitet të quajtur "NewCo" dhe u larguan. Fabrika ka afërsisht 3 hektarë pronë dhe hapësirë të mbuluar prodhimi dhe ndihmë prej 3200 metra katrorë.<sup>30</sup> Sot, ka pak gjasa që një fabrikë e vogël e specializuar e tekstit do të mbijetonte në tregun konkurrues të veshmbathjes. Sidoqoftë, ndërtesa e fabrikës është në gjendje të pranueshme dhe mund të shihet si pasuri apo shtëpi për një përdorim të ri, mundësisht si shtëpi e re për një kooperativë bujqësore ose qendër e vogël për përpunimin e qumështit.

## Punësimi

Shumica e shqiptarëve të Kosovës në fshat nuk janë të punësuar zyrtarisht, dhe shumë punojnë në bujqësi, duke mbajtur bagëti dhe duke prodhuar sasi të kufizuara të qumështit dhe produkteve të mishit për konsum familjar.<sup>31</sup> Kroatët e moshuar kosovarë marrin pension në Kosovë, pasi disa prej tyre marrin pensione serbe, në një rast, nga Gjermania. Ekzistojnë gjithashtu shtatë përfitues të skemës së ndihmës për mirëqenie sociale në Kosovë. Komuniteti gjithashtu merr ndihmë humanitare nga dega e Kryqit të Kuq të Serbisë në fshatin e afërt Vërboc (komuna Kllokot), me shumicë serbe të Kosovës, dhe nga Kisha Katolike lokale.<sup>32</sup>

---

29. "Agjencia Kosovare e Mirëbesimit hap valë të re të privatizimit", 18.07.2007, <https://balkaninsight.com/2007/07/18/kosovo-trust-agency-opens-new-privatisation-wave/>."

30. Intervistat.

31. Intervistat.

32. Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë: Komunitet i cënueshëm* (tetor 2011), <https://www.osce.org/kosovo/83789?download=true> (vizituar më 17.02.2020).

## MJEDISI DHE BUJQËSIA

Letnica ndodhet afër vendit të quajtur mali i zi, i cili është i njohur për natyrën e tij freskuese, ajrin e pastër, pamjet e bukura dhe rrjedhat ujore. Një lum me të njëjtin emër si fshati rrjedh nga malet nëpër vendbanimin e vogël dhe i jep Letnicës karakterin e tij të qetë dhe relaksues. Fatkeqësisht, uji relativisht i pastër është i mbushur me qese plastike dhe mbeturina të tjera. Ka mbeturina përgjatë rrugëve dhe shtigjeve që përshkojnë fshatin. Këto plehra shpërqendrojnë vizitorin nga ajo që përndryshe është një fshat rural idilik, në mjedis të bukur natyror.

Bujqësia në Letnicë zhvillohet vetëm në zona të caktuara në një shkallë shumë të vogël, ku terreni është më i sheshtë, më pjellor, më afër lumit, dhe siguron kushte për kultivim më produktiv. Ka shumë kopshte private të kultivuara me misër, fasule, dhe perime ndërsa fshatarët e tjerë risin lopë dhe dhi. Disa fermerë kanë traktorë, por mungesa e pajisjeve adekuate të nevojshme në fusha është e dukshme, dhe shumica e punës në parcelat e vogla bëhet me dorë, ashtu si në shekujt e kaluar. Aktualisht nuk ka asnjë kooperativë bujqësore në fshat, treg fermerësh, apo sistem zyrtar të shpërndarjes. Topografia e luginës e bën më të vështirë furnizimin me ujë të fushave të punës sipër lumit pasi nuk ka sistem të furnizimit me ujë. Vlerësohet se kultivohet më pak se 20% e tokës së punueshme.

### Infrastruktura

/28

Rruga kryesore për në fshat është e shtruar dhe në gjendje të shkëlqyeshme, por e njëjta gjë nuk vlen për aspektet e tjera të infrastrukturës. Distribucioni i ujit, transporti, ndriçimi rrugorë, mbledhja e mbeturinave dhe ujërat e zeza janë të gjitha në gjendje të keqe ose nuk ekzistojnë. Sistemi ekzistues i furnizimit me ujë u financua nga komuniteti dhe u ndërtua më shumë se 30 vjet më parë. Por, në vitin 2007 ndërmarrja e shërbimeve publike, Hidromorava, vlerësoi sistemin e tubave dhe raportoi se duhej të zëvendësohej plotësisht. Deri në mesin e 2011, komuna kishte deklaruar se nuk kishte fonde për të financuar këtë punë; Sidoqoftë, në korrik 2011 ata njoftuan një projekt për të riparuar pjesërisht sistemin e ujërave parësore në Letnicë dhe Shashar, i cili u përfundua në fund të korrikut 2011.<sup>33</sup> Nga informacionet e marra në terren, sot shumica e shtëpive në fshat nuk kanë ujë të rrjedhshëm pasi tubi kryesor është dëmtuar së fundmi.

33. Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë: Komunitet i cenueshëm* (tetor 2011), <https://www.osce.org/kosovo/83789?doenload=true> (vizituar më 17.02.2020).

Nuk ka sistem të transportit publik drejt fshatit, dhe mënyra e vetme për të udhëtuar në këtë vend të largët është me automjete private. Ndriçimi mungon në të gjitha rrugët e fshatit. Ashtu si në shumë komuna të tjera në Kosovë, sikurse Vitia, mbledhja e mbeturinave gjithashtu paraqet një shqetësim serioz. Fshati Letnicë është një nga vendet ku ky problem është më i theksuar.<sup>34</sup> Përfundimisht, Letnicës i mungon edhe një sistem komunal i kanalizimit që funksionon, ndërkohë që në vend të kësaj mbështetet në gropat septike dhe rezervuarët septik.

## KULTURA, TURIZMI DHE FESTIVALET

Letnicë/ Letnica është mjaft e njohur për kishën të Ngriturit e Zojës së Bekuar në Qiell/ Zoja e Cernagorës, e cila është me rëndësi të madhe për besimtarët katolikë. Duhet gjithashtu të theksohet rëndësia e këtij fshati dhe kishës së tij meqë ishte në këtë vend ku një vajzë e re, Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, dëgjoi thirrjen e Zotit, gjeti frymëzim dhe i kushtoi jetën e saj për të ndihmuar të tjerët; ajo u njoh më vonë si Nënë Tereza. Janë katër ndërtesa të cilat janë përfshirë në Listën e Monumenteve nën mbrojtje të përkohshme të vitit 2018 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Kulla e Ivanit, Kulla e Josipit, Kulla e Nikollë Mitës dhe Mulliri i Frrok Dokiçit, konservimi i të cilit u realizua së fundi gjatë Heritage Lab të vitit 2018, nga Trashëgimi pa Kufij (Ang: Heritage Without Borders).<sup>35</sup>

Ka shumë shtëpi të ndërtuara prej guri. Këto futen në pesë kategori:

1. Rrënoja
2. Të braktisura dhe në kushte të rënda
3. Gjysmë të banuara, ndonëse të mirëmbajtura dhe të banuara gjatë festivaleve dhe fundjavave
4. Të uzurpuara nga persona që nuk janë pronarë legjitimë dhe në gjendje përkeqësimi
5. Të banuara nga pronarët dhe në gjendje përgjithësisht të mirë.

---

34. Instituti GAP, *Komuna e Vitisë: problemet kryesore dhe trendët buxhetor (GAP report)*, <http://www.komunat.institutigap.org/Files/viti/2013/Komuna%20e%20Vitisë%20-%20problemet%20kryesore%20dhe%20trendet%20buxhetore.pdf> (vizituar më 17.02.2020).

35. [https://www.mkrksk.org/repository/docs/Lista\\_e\\_Trashëgimise\\_Kulturore\\_per\\_Mbrojtje\\_te\\_Perkohshme\\_2018.pdf](https://www.mkrksk.org/repository/docs/Lista_e_Trashëgimise_Kulturore_per_Mbrojtje_te_Perkohshme_2018.pdf), f. 42-43, nr. 1259-1262 (vizituar më 20.02.2020) Lista e monumenteve në mbrojtje të përkohshme e 2018, e vlefshme nga 10 tetori 2018 deri 10 tetor 2019.



Figura 14 – Nënë Tereza e Kalkutës (Wes Phelan)

Vizitimi i fshatit, nga pelegrinë fetarë, pasardhës të familjeve që janë larguar nga aty, apo nga persona që thjesht kërkojnë të pushim idilik nga jeta në qytet duket si bazë premtuese për Zhvillimin Ekonomik Lokal. Festat fillojnë me meshën në orën 11:00, më 14 gusht. Kjo meshë mbahet për të përkujtuar bekimin e kishës aktuale më 1931. Pastaj, në mbrëmjen e 14 gushtit, në orën 17:00 mbahet shërbesë tjetër kishtarë në gjuhën kroate dhe një tjetër në gjuhën shqipe, një orë më vonë, gjegjësisht në ora 18:00. Në ora 19:00, statuja e Zonjës së Zezë bartet në krye të kortezhit që fillon në kishë dhe vazhdon përmes fshatit Letnicë. Gjatë natës së 14 dhe 15 gushtit, ndizen qirinjtë dhe njerëzit qëndrojnë në vigjilim nate dhe përpiqen të qëndrojnë zgjuar. Të nesërmen, në orën 06.00 të mëngjesit, dita fillon me meshën në gjuhën shqipe, pasuar nga shërbesa në gjuhën kroate në orën 09.00 dhe meshën kryesore në orën 11.00, në gjuhën shqipe dhe kroate. Pas meshës, Statuja e Zonjës së Zezë nxjerrët edhe një herë në procesion përmes fshatit. Gjatë festimeve, besimtarët orvaten të prekin statujën e Zonjës me stolitë e tyre, dhe shpresojnë të kapin ndonjë pjesë të pëlhurës së Zonjës së Madhe që pritet në copa dhe u shpërndahet pjesëmarrësve.<sup>36</sup> Gjithashtu, gjatë së shtunës së fundit të majit çdo vit, besimtarët kremtojnë në kishë mbylljen e muajit të Shën Mërisë.<sup>37</sup> Ka edhe shërbesa të tjera liturgjike në festat e mëdha fetare siç janë Krishtlindjet apo Pashkët, dhe mesha të rregullta në ditët e diela, por këto nuk janë aq popullore sa festivalet e mëdha.

36. Duijzings, G., *An ethnographic sketch of Letnica, The exodus of Kosovo Croats, A chronicle of ethnic unmixing, Religion and the Politics of Identity in Kosovo*. (Nju Jork: Shtypi i Universitetit Kolumbia, 2000), f.39.

37. Vaticannews, *Mbyllja majit në Shejntëroren e Zojës së Madhe në Letnicë* (30.05.2019), <https://www.vaticannews.va/sq/bota/news/2019-05/letnice-te-zoja-madhe-mbyllet-muj-maj.html>. (vizituar më 17.02.2020).

## **ANALIZË DHE SWOT (PËRPARËSITË, DOBËSITË, MUNDËSITË DHE RREZIQET)**

Gjatë ushtrimeve të Heritage Lab u bë një analizë SWOT (e Përparësive, Dobësive, Mundësive, Rreziqeve) si ushtrim grupi, e cila u verifikua me intervista joformale me pjesëmarrës nga fshati. Kjo ishte treguese jo vetëm sa i përket përparësive të njohura, siç është lidhja me Nënë Terezën, por edhe për mungesën e lehtësirave themelore të nevojshme për mbijetesë. Analiza gjithashtu zbuloi se komuniteti kishte shumë përparësi, por që nuk arrinte t'i shfrytëzonte.

### **Përparësitë**

- Lidhja me Nënë Terezën si vendi i frymëzimit të saj
- Diaspora në Kroaci shpesh kthehet dhe akoma ndjen një lidhje
- Një festival i madh fetar që tërheq mijëra me festivale të tjera më të vogla
- Natyra dhe mjedisi janë kryesisht të paprekura
- Ndërtesat janë tërheqëse, autentike dhe fshati ka integritet
- Largësia relativisht e afërt me zonën kryesore urbane, Prishtinë
- Udhëtimi për në Kroaci mund të bëhet me makinë
- Rrugë shumë të mira në fshat
- Komunitet i fortë me fëmijë dhe një shkollë

### **Dobësitë**

- Komunitet i vogël i ndarë, me shumë pjesëtarë të moshuar
- Nuk ka infrastrukturë, ndriçim të dobët, pa furnizim me ujë, kanalizim të kufizuar
- Asnjë ekonomi tjetër përveç bujqësisë ekzistuese dhe subvencioneve
- Asnjë dyqan, treg apo shitore me pakicë
- Të dhëna të pakta për situatën sociale, kulturën, mungesë hulumtimi
- Asnjë hotel, bujtinë ose shërbim fjetje dhe mëngjes
- Pronarë të shumëfishtë të pronave të braktisura
- Pa vizion për të ardhmen, as plane konkrete
- Mbeturina sipërfaqësore të përgjithshme në rrjedhat ujore dhe rrugë
- Pa asnjë objekt shëndetësor
- Pa infrastrukturë të transportit publik




## Mundësitë


- Një festival i madh dhe festivale të tjera më të vogla mund të zgjerohen për te përfshirë Krishtlindjet dhe Pashkët, gjithashtu meshën e së dielës
- Mjedisi i shëndetshëm dhe bujqësia mund të lejojnë shitjen e drejtpërdrejtë nga fermeri te konsumatori
- Pronaret ne mungesë mund të heqin dorë nga prona për hir të konservimit
- Diaspora mund të kthehet në një numër më të madh, mundësi për shtëpitë verore.
- Fabrika e zbrazët e tekstilit mund të përshtatet në një kooperativë të fermerëve dhe mundësisht prodhimtari në shkallë të vogël
- Kampet e CHwB, mbështetur nga OSBE dhe fokusi i kohës së fundit në fshat
- Distanca e shkurtër me Prishtinën mund të inkurajojë vizitat e fundjavës

## Rreziqet

- Një komunitet i vogël, të moshuarit kanë nevojë për ndihmë
- Familjet mund të lëvizin në kërkim të punës; rinia do të largohet për arsimim/Shkolla mund të mbyllet
- Subvencionet nga Kroacia dhe burime të tjera qeveritare mund të ndalen ose të pakësohen
- Turizmi, ndonëse aktualisht nuk është në nivel të lartë
- Gjendja e dobët e ndërtesave, veçanërisht e shtëpive dhe hambarëve
- Mungesa e aftësive për të kryer konservime në shkallë të vogël si duhet
- Nuk ka mirëmbajtje

Gjatë Heritage Lab, u zhvillua një ushtrim i pemës se problemeve/zgjidhjeve bazuar në hulumtim, intervista, vëzhgime dhe seanca diskutimi. Kjo lloj analize e zbërthen problemin në elementë të menaxhueshëm dhe të plotë për të kuptuar ndërlidhjet dhe hierarkinë e çështjeve dhe kështu lejon caktimin e përparësisë. Ushtrimi filloi me një pemë problemi dhe u debatua në grupe të vogla në një seancë shtjellimi të ideve, ndjekur nga një diskutim mbi zgjidhjet e mundshme. Diagrami i dytë i pemës, si imazh pasqyruar, përmban zgjidhje të sugjeruara për secilin problem. Faqet në vijim janë rezultatet e këtij ushtrimi dhe analize. Rezultatet u diskutuan me disa hisedarë kryesorë për verifikim dhe u përshtatën përputhshmërisht.





# KAPITULLI III - PLANI I PROPOZUAR I ZHVILLIMIT

Ky kapitull përshkruan elementet për planin e propozuar të zhvillimit të Letnicës duke iu referuar katër shtyllave të zhvillimit të qëndrueshëm që janë përshkruar në Kapitullin I. Ai bazohet në kapitujt e mëparshëm dhe identifikon pasuritë duke marrë parasysh analizën e çështjeve dhe nevojave të fshatit.

Këta elementë kryesorë për planin e propozuar përbëjnë vetëm një kornizë paraprake për planin përfundimtar të zhvillimit dhe mund të kenë nevojë për ndryshime. Procedura përcjellëse mund të ndërmerret, p.sh., përmes një laboratorit tjetër të trashëgimisë që përfshin sa më shumë hisedarë. Hartimi i planit të propozuar të zhvillimit trajton jo vetëm një gamë të gjerë çështjesh, por duhet të përfshijë gjithashtu shumë hisedarë të cilët do të japin kontributin e tyre për zbatimin e planit. Ndërsa plani i ardhshëm i zhvillimit do të sigurojë përcaktimin programatik, menaxherial dhe legjislativ, është plani i veprimit ai i cili do të tregojë "udhërrëfyesin" për zbatimin e duhur të planit të zhvillimit. Planin e veprimit do ta shndërrojë planin e zhvillimit në një dokument operativ duke trajtuar detyrat dhe aktorët e përfshirë.

## SOCIAL

Planin e zhvillimit duhet të fillojë me aspektet sociale të fshatit. Duke iu referuar edhe një herë faktorëve kryesorë që cekën në Kapitullin I:

1. Një ndjenjë të vendit dhe përkatësisë
2. Mundësitë për aktivitete kolektive
3. Mundësitë për të ndërtuar rrjete sociale
4. Dizajn që inkurajon bashkëveprimin
5. Inkurajimi i sjelljes pro - mjedisore

Nga vëzhgimet dhe intervistat është e qartë se Letnica tashmë ka një ndjenjë të vendit për ata të cilët ende jetojnë në fshat, duke qenë se ata nuk kanë pranuar të largohen. Por ndjenja e përkatësisë shtrihet edhe në diasporë dhe tek besimtarët fetarë. Sidoqoftë, kjo jo domosdo përkthehet në zhvillim të mjaftueshëm shoqëror për të ruajtur komunitetin dhe fshatin. Ndjenja e përkatësisë është disi e gërryer, duke pasur parasysh dy elementët e veçantë të një bashkësie të gjallë dhe që përkeqësohet nga shkëputja e kishës nga fshati. Prandaj, duhet të ketë një program të zhvillimit shoqëror që funksionon së bashku me të dy pjesët e

komunitetit dhe që e angazhon kishën. Identifikimi i nevojave dhe mobilizimi i hisedarëve duhet të arrihet përmes qasjes poshtë-lart. Prandaj, propozimi i parë në këtë plan zhvillimi është që të punohet me komunitetin për të krijuar një vizion të përbashkët për të mbështetur zhvillimin. Kjo mund të bëhet përmes një kampi të ardhshëm të Heritage Lab ose një aktiviteti tjetër, siç është një tryezë e rrumbullakët, duke i bërë bashkë të gjithë aktorët e mundshëm, përfshirë autoritetet, përfaqësuesit e shoqërisë civile, pjesëtarët e bashkësive fetare, grupet dhe organizatat e specializuara (p.sh., universitetet dhe organizatat për zhvillim) si dhe ekspertët individualë të cilët mund të hartojnë dhe bien dakord për një plan veprimi në mënyrë që të formulojnë hapat e ardhshëm dhe gjithashtu të identifikojnë mjetet e nevojshme financiare. Përfshirja e banorëve lokalë në identifikimin, hartimin dhe procesin e vendimmarrjes do të rezultojë me "pronësi" të lartë dhe të nevojshme të këtyre propozimeve mes banorëve të Letnicës dhe do të sigurojë zbatim efikas të planit "të tyre" të zhvillimit.

Aktualisht, nuk ka përpjekje të bashkërenduara për zhvillimin shoqëror; prandaj, aspekti i dytë kritik i këtij plani zhvillimi është krijimi i fondacionit "Letnica Thërret", ashtu që të gjithë ta kenë mundësinë për të kontribuar dhe që zhvillimi mund të drejtohet në aspektin lokal. Një fondacion i tillë mëton që të angazhojë të gjithë anëtarët e komunitetit për të planifikuar për të ardhmen, ndërsa inkurajon bashkëpunimin brenda komunitetit si dhe krijimin e lidhjeve me rajonin më të gjerë. Fondacioni pastaj mund të kërkojë mbështetje dhe fonde për zhvillim, si dhe mund të veprojë si avokat për nevojat e komunitetit. Ajo çka është më e rëndësishmja, ai mund të ofrojë mundësi për veprimtari kolektive dhe mund të lehtësojë rrjetet sociale.

Familjet janë thelbësore për të siguruar të ardhmen e Letnicës. Prandaj, duhet ndërmarr një përpjekje të përbashkët për të mbajtur familjet ekzistuese dhe për të tërhequr anëtarët e rinj të komunitetit. Aspekti më tërheqës është punësimi, dhe kjo do të trajtohet në pjesën tjetër, por ka edhe aspekte të tjera përfshirë sigurimin e banimit, të cilat mund të realizohen përmes rinovimit të shtëpive ekzistuese historike, ofrimit të shërbimeve themelore dhe mirëmbajtjes së shkollës. Një nga aspektet më kryesore të tërheqjes së familjeve ose çifteve është prania e një shkolle. Letnica është me fat që ka fëmijë në fshat dhe një objekt shkollor që ende funksionon. Është jetike që kjo shkollë të mbështetet deri në fëmijën e fundit dhe madje të zgjerohet me klasa shtesë për të rritur, dhe një kënd të lodrave. Në ndërtesën ekzistuese mund të organizohen edhe tubime sociale.

Krejt në fund, ekzistojnë shërbimet themelore sociale që duhet të trajtohen. Këtu përfshihet një klinikë funksionale e kujdesit shëndetësor me një mjek të rregullt vizitues dhe një sistem të ambulancës për në spitalin e Vitisë. Lidhjet e transportit publik gjithashtu duhet të përmirësohen me një shërbim të dedikuar me autobus, i cili gjithashtu do të përmirësojë qasjen në kujdesin shëndetësor dhe arsimim. Një stacion ekzistues i autobusëve është vetëm gjashtë kilometra larg, dhe një linjë mund të zgjerohet, e cila gjë do të ndikojë në komunitet. Shërbimet e tjera themelore siç janë projektet e infrastrukturës do të trajtohen në seksionin për mjedisin.

## EKONOMIA

Edhe me një theks të veçantë në zhvillimin shoqëror, aspektet ekonomike nuk mund të injorohen, thjesht sepse ato sigurojnë mjetet për komunitetin për të mbijetuar dhe për të tërhequr familje të reja. Siç u tha më herët në Kapitullin II, ekonomia e tanishme bazohet në bujqësi ekzistenciale dhe subvencione - kjo mund të tingëllojë si një situatë e rëndë, por për fat të mirë, ka pasuri në Letnicë me të cilat mund të punohet, përkatësisht bujqësia, turizmi dhe ndoshta prodhimi i kufizuar. Marrëveshja dhe përfshirja aktive e shumë hisedarëve të ndryshëm të Letnicës, komunës, ministrive dhe sektorëve të tjerë (p.sh., kisha katolike e fshatit) për drejtimin e zgjedhur dhe hapat e ndërmarrë do të lehtësojnë fillimin e këtyre nismave.

### Bujqësia

Aktualisht, prodhimi bujqësor është i kufizuar në konsumin lokal, që nuk është i bashkërenduar dhe që është joefikas. Prandaj, duhet të krijohet dhe duhet të vihet në funksion një plan për të organizuar përpjekjet, për të rritur prodhimin dhe për ta shtuar vlerën. Ky plan mund të fillojë me një studim të praktikave ekzistuese të prodhimit bujqësor, identifikimin e tokës në dispozicion për prodhim me një rendiment të qëndrueshëm ose të rritur, dhe, ajo çka është e rëndësishme, me trajnime për fshatarët. Një plan i tillë mund del me një kooperativë dhe modelin nga ferma drejtpërdrejtë në treg ose një program me prodhime organike. Programe të tilla kanë qenë të suksesshme në lokacione të tjera rurale dhe u lejojnë fshatarëve që të bashkërendojnë përpjekjet e tyre dhe të shesin drejtpërdrejtë te konsumatorët e regjistruar në qendrat urbane siç është Prishtina. Këto programe përfshijnë organizimin e prodhimit aktual, mundësojnë ndarjen e burimeve dhe pajisjeve, promovimin përmes marketingut, brendimit lokal dhe mekanizmave të dërgimit. Një ide premtuese është përdorimi i fabrikës ekzistuese të tekstilit, që është e mbyllur, për kooperativën bujqësore dhe mundësisht të shndërrohet në një qendër të kufizuar të prodhimit të qumështit. Përderisa këto janë ide ambicioze, ato nuk janë joreale duke pasur parasysh që ka prodhimtari bujqësore në vazhdim e sipër, një treg organik që lulëzon, shumica e fshatarëve janë interesuar shumë, dhe ekziston një lidhje mes Letnicës dhe një mjedisi të shëndetshëm natyror në male, gjë që mund të jetë një faktor dallues.

### Turizmi

Përkundër famës së Letnicës me "Zonjën e Zezë" dhe lidhjen e saj me Nënë Terezën, fshati përfiton shumë pak në kuptimin ekonomik nga pelegrinët fetarë. Mijëra vizitorë, të cilët vijnë për Festën e Zonjës vendosen në hapësirat e kishës dhe shitësit vijnë nga fshatrat fqinje për të vendosur kioska e përkohshme për ushqim dhe suvenirë. Ky nuk është domosdo faji i komunitetit; ata thjesht nuk arrijnë të përfitojnë nga përparësia e aseteve të tyre të trashëgimisë kulturore. Përveç kësaj, ekziston vetëm një festival i madh që është i shkurtër, i cili zgjat vetëm dy ditë.

Me qëllim që fshati të përfitojë më shumë nga pasuritë e tij kulturore në aspektin ekonomik, janë të nevojshëm disa hapa. Festa kryesore e Zonjës duhet të zgjatet për më shumë se dy ditë, dhe festat shtesë duhet të vendosen dhe promovohen, të tilla si Krishtlindjet, Pashkët, data e kanunizimit të Nënës Terezës, madje dhe ditëlindja e saj. Përtej vizitave fetare, pasuritë mjedisore të fshatit duhet të promovohen si një udhëtim i shëndetshëm gjatë fundjavës nga qytetet afër. Duhet të krijohen atraksione shtesë të tilla si shtigje malore, shtigje përgjatë lumit, apo ngjarje të tjera të tilla si kurse të natyrës apo artit. Këto aktivitete duhet të rrisin kërkesën për vizita dhe për të përmbushur ofertën, disa shtëpi ekzistuese të lira duhet të rinovohen dhe shndërrohen në shtëpi për mysafirë ose për fjetje e mëngjes. Meqenëse fshati është i vogël, duhet të kryhet një studim i kapacitetit mbajtës për të vlerësuar nëse vizitat e festivaleve duhet të promovohen të tilla si Pashkët ose Krishtlindjet. Pothuajse është e sigurt se në zonat me trafik të lartë rreth kishës, ky kapacitet tejkalohet për festivalin e shkurtër të Zonjës së Zezë. Sidoqoftë, raportet tregojnë se brendësia e fshatit është e zbrazët gjatë kësaj kohe.

Në mënyrë që shitësit lokalë të përfitojnë nga vizitorët, një ide është krijimi i një programi certifikimi, "prodhuar në Letnicë", si dhe një tarifë ose një sistem licencimi për të gjithë shitësit që vijnë, i cili do të shkon në një fond konservimi për të mbështetur fshatin. Përfundimisht, banorëve duhet t'u jepin informata për të drejtuar vizitorët në mënyrë që ata të mund ta njohin dhe ta vlerësojnë më mirë Letnicën.

### Prodhim në shkallë të vogël

Aspekti i fundit është ndërmarrja e një pilot projekti për krijimin e produkteve të prodhuara ose të rritura në Letnicë. Këto mund të jetë perime organike, mish, kos, dhe produkte të tjera të qumështit, të cilat mund të shiten në fshat ose edhe më larg. Kjo do të rrisë prodhimin dhe do të shtojë vlerën e mallrave. Një ide e hulumtuar shkurtimisht gjatë punëtorisë ishte prodhimi i qirinjve për shitje turistëve ose pelegrinëve. Produkte të tilla të thjeshta janë në dobi të vendit dhe ndihmojnë për krijimin e markës Letnicë e që nuk mund të kopjohet lehtë.



Figura 16 – Shtëpitë e braktisura mund të përshtaten në shtëpi për mysafirë. Foto: Rand Eppich



*Figura 17 – Shumë kopshte të mirëmbajtura mirë mund të zgjerohen për të shërbyer në restorantin kroat.  
Foto: Rand Eppich*



*Figura 18 – Mulliri i konservuar në kohët e fundit po tërheq interes dhe vizitorët e fundjavës.  
Foto: Rand Eppich*



*Figura 19 – Qasja automobilistike deri në fshat nuk ofron një mjedis mikpritës.  
Foto: Rand Eppich*



## MJEDISI

Letnica ndodhet në një mjedis të bukur natyror. Fshati është i shtritur brenda një gryke mes maleve me një përrua që rrjedh gjatë tërë vitit përmes fshatit. Në verë kodrat janë blerta dhe në vjeshtë gjethet ndryshojnë në ngjyrë bojëkafë të kuqe dhe të artë. Ekziston një shteg i vogël që ndjek rrjedhën, që dredhet nëpër fshat dhe që zhduket në male. Në zonat fushore ka kopshte me perime që janë të mirëmbajtura mirë e të rrethuara me mure dhe fusha për bagëtinë. Sidoqoftë, si festat fetare, komuniteti nuk e vlerëson plotësisht këtë pasuri ose përfitim. Prandaj duhet të ndërmerren disa veprime në lidhje me mjedisin.

Fshatarët duhet të jenë të vetëdijeshom se ata janë kujdestarë të mjedisit dhe se veprimet e tyre, sado të vogla, ndikojnë në mjedisin e tyre. Kjo përpjekje për ndërgjegjësim mund të merr formën e kampeve të ardhshme të laboratorëve për trashëgiminë të CHwB, udhëhequr nga Misioni i OSBE-së në Kosovë apo ndonjë organizatë tjetër. Një përpjekje shtesë e kampeve të tilla mund të jetë pastrimi i përroit nga mbeturinat dhe zvogëlimi i mbeturinave sipërfaqësore në rrugët brenda fshatit. Në këtë aspekt, pikat e veçanta për grumbullimin e mbeturinave apo kontejnerët duhet të rivendosen, të mbahen të pastra, të zbrazen shpesh dhe duhet të identifikohet dhe krijohet një vend i caktuar i ngarkimit. Veprimet e tilla do të vëreheshin dhe do ta bënin Letnicën më të këndshme për komunitetin dhe vizitorët.

Përtej fshatit të afërm, ka vetëm disa shtigje për ta shijuar mjedisin. Një shteg i tillë i identifikuar mund të jetë përgjatë lumit, dhe një tjetër mund të krijohet në kodra. Një shteg larg fshatit mund të krijohet për të përfituar nga ndryshimi në lartësi për të parë fshatin nga pas. Vende të caktuara kampingu gjithashtu mund të identifikohen dhe të zhvillohen jashtë fshatit për të shpërndarë pelegrinët në një zonë më të gjerë dhe për të rritur kapacitetin.

/40



Figura 20 – Ekonomia lokale rurale bazohet në bujqësinë për ekzistencë dhe subvencionet. Foto: Rand Eppich

Këto kampe mund të vendosen brenda kodrave me pamje prapa nga kisha dhe fshati. Qasja deri në fshat është me pamje të Kishës Katolike dhe në fund të kodrës, një parking i madh asfalti. Kuptohet se ai është për automjete dhe shitës. Shitësit do të shpërndaheshin më mirë në fshat, dhe kjo krijoi hapësirë për ta bërë këtë vend parking të madh më të bukur.

Aspekti i fundit në lidhje me zhvillimin e mjedisit ka të bëjë me infrastrukturën për të mbështetur një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Është e nevojshme që të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë të pijshëm si dhe ai i sistemit të kanalizimit. Një studim i veçantë duhet të bëhet konkretisht për këtë.

Peizazhi, bashkë me fshatin, kontribuojnë për formimin e kulturave lokale dhe është një komponentë bazike e trashëgimisë kulturore që kontribuon për mirëqenien e njerëzve dhe identitetin evropian.<sup>38</sup> Peizazhet kulturore, arkitektura popullore dhe komunitetet janë arkiva të gjalla që duhet të përdoren për të shtuar njohuritë tona për historinë, artin, kulturën, klimën, adaptimin, inovacionin, bujqësinë dhe qëndrueshmërinë.

## KULTURA

